



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
Odeljenje za Kulturu, Omladinu i Sport

XIII Nr. i prot.
Br. prot.

Më 02.09.2022
Dt.

Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit / Opština Orahovac / Municipality of Rahovec
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
Odeljenje za Kulturu, Omladinu i Sport
Department of Culture, Youth and Sport



Datë/Datum/Date:	23.9.2022
Referenc-ë	
Për/Za/To:	Kuvendin e Komunës së Rahovecit
CC:	
Nga/Od/From:	z. Afrim Dina, Drejtor për Kulturë, Rini dhe Sport
Subjekti/Predmet/Subject	Informatë:

-Informatë për muajin e mërgimtarëve prej 15 korrik deri më 15 gusht 2022:

Të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal!

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport si bartëse e të gjitha aktivitete për muajin e mërgimtarëve ju paraqet dhe informon për mbarëvajtjen e të gjitha aktivitete nga 15 korrik deri më 15 gusht 2022.

Manifestimi dhe organizimi i aktiviteteve "Ditët e mërgatës" ka filluar sipas agjendës e cila është hartuar nga Kryetari i Komunes dhe e publikuar në Vebfaqen e komunës me datë: 12.7.2022.

Manifestimi tradicional "Ditët e mërgatës", që nisi më 15 korrik dhe u përmbyll më 15 gusht, ishte ndër më të organizuarit deri më tani.

Me qëllim të ofrimit të mundësisë për takime reciproke ndërmjet mërgimtarëve tanë dhe takimeve me autoritetet lokale, Komuna e Rahovecit – DKRS ka organizuar aktivitete të shumta si: Turne në futboll, shah, koncerte dhe ndeja me mërgimtarët në disa lokalitete.

Ndërsa kryetari i komunës z. Smajl Latifi ka pritur në zyrën e tij shumë mërgimtarë, çdo ditë duke filluar nga ora 10:00 me të cilët ka biseduar për gjendjen socio-ekonomike në komunën e Rahovecit, si dhe ka dëgjuar shqetësimet e tyre.

Përveç pritjeve të organizuara nga kryetari Latifi, mërgimtarët tanë kanë pasur mundësi të argëtohen nga artistët e estradës kosovare.

Grupe dhe muzikantë të njohur, siç janë: "Fisnikët", "04 Band" dhe artistë të tjerë të komunës së Rahovecit.

Ndër aktivitetet e pëlqyeshme ka qenë edhe organizimi i veprimtarisë “Sofra e mërgimtarit”, të mbajtura në Drenoc, Krushe e Madhe dhe Ratkoc, që është pritur shumë mirë nga pjesëmarrësit e shumtë.

Në kuadër të këtyre manifestimeve janë promovuar edhe dy vepra me karakter dokumentar dhe shkencor. Promovimi i monografisë “Deri në frymën e fundit” për dëshmorin Skender G. Gashi, i cili ishte kthyer nga mërgimi për të luftuar për lirinë e Kosovës, me autor Qemajl Krasniqi, u prit mirë nga shokët e tij mërgimtarë dhe bashkëluftëtarët e tij. Ndërsa libri “100 kultivar hardhie” e mërgimtarit të pasionuar pas rrushit dhe verës Rexhep Kryeziu, u mirëprit nga kultivuesit vendor të rrushit.

Përveç këtyre aktiviteteve u organizua edhe turneu dy ditor ndërkombëtar i shahut „Korriku 98“, që u organizua për herë të parë në komunën e Rahovecit në këtë periudhë të vitit. Në turne morën pjesë 106 garues nga Kosova, Shqipëria, Finlanda, Austria, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut.

Mërgimtarët kanë pasur mundësi të marrin pjesë edhe në turneun e futbollit, që u organizua enkas për dashamirësit e këtij sporti.

Pjesëmarrja e madhe e qytetarëve në këto aktivitete nga data 15 korrik deri më 15 gusht, është dëshmia më e mirë se organizimet kanë qenë në nivel dhe se janë përmbushur në masë të koniderueshme pritjet e mërgimtarëve tanë.

Sipas të dhënave të vëzhguesve tanë, në këto aktivitete kanë marrë pjesë rreth 12,000 qytetarë për gjatë 30 ditëve.

Më poshtë përmesë imazheve apo fotografive po ju paraqesim të gjitha aktivitetet e mbajtura si në Qytet ashtu edhe në vendbanimet ku janë mbajtura aktivitetet.


Turneu në futboll të vogël i mbajtur më 15.7.2022 në Palestrën “Mizahir Isma”



Turneu ndërkombëtar i shahut „Korriku 98”, mbajtur më 23-24 korrik 2022, që u organizua për herë të parë në komunën e Rahovecit.



Grupi muzikor “04 BAND” 20.7.2022 në Rahovec.




Përrurimi i hapësirës rekreative dhe këndit të lojrave në “Majën e Shkodranit”, 21.7.2022



Sofra e Mërgimtarit në Drenoc 28.7.2022.



Grupi muzikor "FISNIKËT" 23.7.2022 në Rahovec.





Grupi muzikor "04 BAND" 9.8.2022 në Rahovec.



Sofra e Mërgimtarit në Krushë të Madhe 2.8.2022.



Promovimi i monografisë “Deri në frymën e fundit” për dëshmorin Skender G. Gashi i autorit Qemajl Krasniqi 2.8.2022.




Promovimi i librit “100 kultivar hardhie” e mërgimtarit të pasionuar pas rrushit dhe verës i autorit Rexhep Kryeziu



TAKIMI ME BIZNESE VENDORE DHE ATO NGA DIASPORA 12.8.2022



Përmbyllja e aktiviteteve me Grupin muzikor "04 BAND" 15.8.2022 në Rahovec



Të gjitha aktivitetet e filluara me 15 korrik deri më 15 gusht në komunën tonë kanë qenë në nivelin të lartë, kjo falë bashkëpunimit dhe koordinimit me Policinë e Kosovës në Rahovec dhe QKMF-së të cilët na mbështeten tërë kohën e mbajtjes së aktiviteteve.

Gjithësesi dua të falenderoj edhe të gjitha bizneset për kontributin e tyre ku janë mbajtur koncertet në rrugën "Xhevat Kasapi".

Rahovec, shtator 2022

